

VENDIM
Nr.21, datë 4.3.2011

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “KORKIS-2009” SHPK NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe 13 pika 1, germa “a”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe 13 dhe 14 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.3.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Korkis-2009” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Korkis-2009” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Korkis-2009” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Belesova 1” me fuqi 0.150 MW dhe “Belesova 2” me fuqi 0.280 MW.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta